

VENDIM

Nr .180, date 13.4.2000

PER SHPALLJEN ANSAMBEL MONUMENT- KULTURE TE AKSIT KRYESOR DHE QENDRES HISTORIKE TE QYTETIT TE TIRANES

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 2 dhe 16, te ligjit nr. 7867, date 12.10.1994, "Per mbrojtjen e pasurise kulturore te luajtshme dhe te paluajtshme" , me propozimin e ministrit te Kultures, Rinise dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpallet "Ansambl monument-kulture", aksi qendror dhe qendra historike e qytetit te Tiranes, sipas planimetrise qe i bashkelidhet ketij vendimi.
 2. Kufijte e ketij ansambli jane: Nga sheshi perpara stacionit te trenit, pergjate shtetitores "Deshmoret e Kombit", deri prapa hotel Tiranes". Vazhdon pergjate rruges "U. Pano", deri ne kryqezimin me "Rrugen e Barrikadave". Pergjate "rruges se Barrikadave", deri ne kryqezimin e saj me rrugen "Punetoret e Rilindjes". Pergjate rruges "Punetoret e Rilindjes" deri tek "Ura e Tabakeve". Pergjate bulevardit "Zhan D'Ark" deri tek ura e "Rruges se Elbasanit". Kalon uren dhe vazhdon ne bulevardin "Bajram Curri" deri ne kryqezimin me rrugen "Lek Dukagjini". Pergjate rruges "Lek Dukagjini" deri te stadiumi "Qemal Stafa". Pergjate rruges qe perfshin stadiumin "Qemal Stafa", duke perfshire 100 m thellesi ne jug te rruges perpara Universitetit Politeknik, deri te sheshi perpara Gardes se Republikes. Nga sheshi perpara Gardes se Republikes, pergjate rruges "Deshmoret e 4 shkurtit" deri ne kryqezimin me "Rrugen e Kavajes". Pergjate "Rruges se Kavajes" deri te sheshi ne krah te "Lidhjes se Shkrimtareve". Nga ky shesh pergjate rruges "Kajo Karafili" deri ne kryqezimin me rrugen "Ded Gjo Luli". pergjate rruges "Ded Gjo Luli" deri ne daljen ne shetitoren "Deshmoret e Kombit" .pergjate shetitores "Deshmoret e Kombit" deri te sheshi perpara stacionit te trenit.
 3. Te gjitha ndertimet e perkohshme apo te perhershme, te paligjshme, te hiqen brenda fundit te vitit ne vazhdim, sipas nje plani te specifikuar nderhyrjeje.
 4. Ngarkohen Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Puneve Publike qe, ne bashkepunim me institucionet e specializuara, te realizojne projektin per ruajtjen dhe restaurimin e elementeve perberes te ansamblit te mesiperm, ne pergjithesi.
 5. Per bashkerendimin dhe zbatimin e ketij projekti krijohet grupi i punes, me 3-5 anetare, te cilet caktohen nga Kryeministri.
- Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta